



**MALI I ZI**  
**Qeveria e Malit të Zi**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**ENTI PËR SHKOLLIM**

**Katalogu i njohurive – programet e lëndëve**

**GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**  
**Klasa I, II, III dhe IV-të shkolla e mesme profesionale**



**Podgoricë 2009.**

Programi i lëndës

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Klasa I, II, III dhe IV-të shkolla e mesme profesionale

Botuesi: Enti për Shkollim  
Redaktori: dr Dragan Bogojević  
Lektor: Dimitrov Popović i Jasmina Radunović  
Përgatitja teknike: Nataša Perić  
Štypi: "IVPE" Cetinje  
Tirazhi: 100

Podgoricë, 2009.

Në bazë të nenit 35, dispozita 1, alinea 1, të Ligjit të përgjithshëm të arsimit dhe edukimit („Fleta zyrtare e RMZ“, nr.64/02, 31/05 dhe 49/07), Këshilli për arsim të përgjithshëm, në mbledhjen e 47-të të mbajtur më 25 qershor të vitit 2008, ka aprovuar katalogun e njohurive për **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI** me fondin 3 orë në javë për klasën e I, II, III dhe IV të shkollave të mesme profesionale, **GJUHË ZYRTARE JOAMTARE** me fondin 2 orë në javë për klasën I, II, III dhe IV, kurse në mbledhjen e dytë të Këshillit të arsimit të përgjithshëm të mbajtur më 15. qershor të vitit 2009 ka aprovuar katalogun e njohurive për **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI** – lëndë zgjedhore me fondin prej 2 orëve në javë si lëndë zgjedhëse për klasën e III e IV të shkollave të mesme profesionale.

## 1. EMËRTIMI I LËNDËS MËSIMORE GJUHË AMTARE DHE LETËRSI

### EMËRTIMI I PROGRAMIT TË LËNDËS GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

## 2. PËRCAKTIMI I PROGRAMIT TË LËNDËS

*Lënda mësimore* Gjuhë shqipe dhe letërsi është i obliguar gjatë mësimit katërvjeçar në shkollën e mesme profesionale dhe i nënshtrohet provimit të maturës. Mësimi i gjuhës shqipe është bazë e procesit mësimor që ka për qëllim të zhvillojë tek nxënësi dëshirën për mësim dhe përdorimin e gjuhës amtare si mjeti themelor i komunikimit. Gjuha e letërsia shqipe është shenjë karakteristike e identitetit kombëtar gjatë gjithë shkollimit fillor dhe të mesëm në shkollat me mësim në gjuhën shqipe.

Gjatë mësimit të gjuhës amtare dhe letërsisë, nxënësi zhvillohet si person i pavarur, i lirë, kreativ e kulturor, i ndërgjegjshëm për identitetin personal dhe nacional. Nxënësi përmes gjuhës dhe letërsisë shqipe mësohet që të vlerësojë gjuhën dhe kulturën e vet, gjuhën dhe kulturën e popujve të tjerë në vendin ku jeton, si dhe të njohë vlerat më të mira kulturore të njerëzimit.

Nxënësi aftësohet për t'u marrë vesh e komunikuar qartë, kuptueshëm dhe drejt me gojë ose me shkrim në rrethana nga më të ndryshmet. Nxënësi zotëron teknikën e leximit dhe të shkrimit. Ai pas leximit ose dëgjimit të teksteve letrare ose jo letrare është në gjendje të nxjerrë konkluzione, të vlerësojë në mënyrë kritike etj.

Lënda e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, i ofron nxënësit të zhvillojnë botën vet emocionale, të rrisë shijet estetike dhe të figurshme për botën, të përjetojë vlerat letrare kombëtare e botërore të cilat krijojnë shprehitë që vetë nxënësi të zgjedhë e vlerësojë literaturën që i përshtatet.

Shkathtësitë që zhvillohen në kuadrin e kësaj lënde, pothuaj se praktikohen edhe në lëndët e tjera për këtë arsye ka rëndësi në kuadër të kurikulimit në tërësi.

Gjysma e orëve të lëndës *gjuhë e letërsi shqipe* i janë dedikuar gjuhës, kurse gjysma tjetër letërsisë. Në kuadër të kësaj ndarjeje, orët ndahen në orë teorike dhe në forma të tjera të mësimit për të gjithë nxënësit e paraleles, si dhe ushtrime dhe forma të tjera që e ndajnë paralelen në grupe më të vogla.

Klasa	Fondi javor i orëve
Klasa I	3
Klasa II	3
Klasa III	3
Klasa IV	3

Në kuadër të programit, për çdo vit planifikohet mësimi i zgjedhur deri në 20% të orëve të parashikuara. Këtu është fjala për materialet e përgatitura nga letërsia që krijohet në hapësirën lokale.

### 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË PROGRAMIT TË LËNDËS

1. Nxënësit zhvillojnë aftësitë e shprehjes dhe komunikimit në gjuhën amtare. Ata arrijnë të shprehin dhe të arsyetojnë mendimet e veta, të dëgjojnë, pyesin e përgjigjen për atë çka i pyesin të tjerët, si dhe të kuptojnë rëndësinë e mesazheve jo verbale.
2. Mjeshtërinë e shprehjes dhe të komunikimit nxënësit e fitojnë nga shembujt e teksteve të ndryshme që dëgjojnë, lexojnë e shkruajnë dhe nën udhëheqjen e mësimit nxënësit mësohen për t'i kuptuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike. Në bazë të kësaj, nxënësit aftësohen që të hartojnë vetë tekste të ngjashme, të kuptueshme e të drejta nga ana gjuhësore.
3. Nxënësit aftësohen në komunikim me gjuhën letrare, dinë principet dhe normat e saj dhe i përdorin për hartimin e teksteve gojore dhe të shkruara. Pasi që mësimi bazohet në shembujt më të mirë të teksteve letrare dhe atyre jo letrare, nxënësit formojnë kuptimin e plotë për strukturën fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore të gjuhës amtare. Nxënësi po ashtu aftësohet në përdorimin e stileve funksionale në të folur ose në të shkruar.
4. Duke i zhvilluar shkathtësitë e komunikimit, nxënësi socializohet dhe bëhet i ndërgjegjshëm se ka mundësi të ndikojë në rrethin e vet dhe të marrë pjesë në jetën shoqërore.
5. Gjatë mëimit të letërsisë, nxënësi zhvillohet si personalitet i lirë dhe kreativ, zhvillohet ndjenja e identitetit kulturor kombëtar dhe i përvetësimi të vlerave më të mira humane e civilizuese botërore.
6. Nxënësit mësojnë të marrin pjesë në gjithë llojet e aktiviteteve jashtë mësimore dhe në gara si dhe të bashkëpunojnë me gazeta, revista dhe radiotelevizione.
7. Nxënësit edukohen me frymën e tolerancës gjuhësore, respektimin e gjuhëve të tjera që fliten në rrethin ku jeton.

#### 4. PËRMBAJTJA DHE QËLLIMET OPERATIVE TË PROGRAMIT TË LËNDËS

Qëllimi themelor i gjuhës e letërsisë shqipe është të zhvillojë katër shkathtësitë:

- **dëgjimi** (të kuptuarit e asaj se çfarë dëgjojnë)
- **të folurit** (të folurit qartë, kuptueshëm dhe drejt)
- **të lexuarit** (të kuptuarit e asaj që lexohet)
- **të shkruarit** (sipas normave gramatikore e drejtshkrimore në kuadër të stileve të ndryshme funksionale)

Programi i ri mësimor duhet të zvogëlojë ngarkesën dhe lodhjen e nxënësve. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme, jo vetëm të lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe, por edhe të lëndëve tjera, pra e mbarë shkollës së re që po e projektojmë. Shkolla nuk do të ketë funksion informativ, por funksion të ri formues e socializues. Kahet e reja të programeve janë drejt qëllimeve dhe rezultateve në mësim. Kjo nënkupton përvetësimin e dijeve kualitative dhe të zbatueshme. Nxënësit duhet të dalin nga shkolla të përgatitur për komunikim në gjuhën amtare. Programi i ri mësimor nënkupton edhe krahasimin me standardet ndërkombëtare të dijeve.

Vazhdojnë tabelat në të cilat janë zhvilluar:

1. **Qëllimi operativ** ( formuese, informative, socializuese dhe speciale)
2. **Aktivitetet** ( proceset përmes të cilave nxënësit realizojnë synimet e mësipërme)
3. **Nacionet dhe përmbajtjet** (përfshijnë përmbajtjet tematike lidhur me mësimin e gjuhës dhe të letërsisë)
4. **Korelacioni** (lidhja e lëndëve me njëra-tjetrën me qëllim të shfrytëzimit të njohurive të ndryshme të fituara më parë në procesin e përvetësimit të njohurive të reja)

**KLASA I**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>1.Nxënësi aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për të njohur dhe përdorur gjuhën si mjet komunikimi; --- për të njohur funksionet e saja për të shprehur ndjenjat, mënyrat e komunikimit, mesazhet etj.;</li> <li>- të zhvillojë aftësinë për të hulumtuar lashtësinë e saj, ndikimet e gjuhëve të huaja; - të njohin dhe dallojnë dialektet, gjuhën e folur dhe të shkruar letrare etj.</li> </ul>	<p>1. Nxënësit e njohin gjuhën shqipe si mjet komunikimi, bëjnë dallimin e saj me gjuhët tjera, flasin për rolin e saj në shoqëri, njohin variantet e saj, hulumtojnë, gjejnë tekste të shkruara në variante të ndryshme dhe i lexojnë në klasë, bëjnë dallimin në mes tyre, vlerësojnë, gjykojnë etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallojnë dialektet kryesore të gjuhës shqipe, lexojnë pjesë, apo dëgjojnë pjesë të lexuara nga mësimsdhënësi në të dy dialektet kryesore, bëjnë skemën ku krahasojnë fjalët e të dy dialekteve, bëjnë dallimin e tyre me gjuhën letrare, përpilojnë fjalorin dhe hulumtojnë për të gjetur fjalë të tjera;</li> <li>- dëgjojnë, lexojnë dhe njohin shtresat e gjuhës (zhargonet dhe sociolektin), sa përdoren, ku përdoren, sa janë të kuptueshme për ta etj.</li> <li>- Njohin dhe komunikojnë në gjuhën letrare, njihen me rregullat (normat) dhe standardizimin e saj, zhvillimin dhe kontaktet e vazhdueshme me gjuhët e tjera, bëjnë dialog për rëndësinë e kongreseve në unifikimin e gjuhës.</li> </ul>	<p>MËSIMI I GJUHËS:</p> <p>1. Gjuha si mjet komunikimi;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Roli i gjuhës në shoqëri;</li> <li>- Variantet e gjuhës shqipe;</li> <li>- Dialektet kryesore të gjuhës shqipe.</li> </ul>	<p>Gjeografi, Histori,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillojnë aftësitë për të njohur dhe për të ditur, për të folur drejt gjuhën letrare, për të njohur normat dhe standardizimin e saj, thellojnë njohuritë dhe aftësitë për t'u shprehur, për të hulumtuar, vlerësuar dhe gjykuar;</li> <li>- të aftësojë nxënësit që të njohin degët e gjuhësisë, alfabetin e gjuhës shqipe, ndarjen e tingujve, të shqiptojnë dhe të flasin bukur, në mënyrë të pavarur dhe të zhvillojnë aftësinë krijuese;</li> <li>- aftësohen për të hulumtuar në mënyrë të pavarur ecurinë e përpjekjeve për përpilimin e një alfabeti unik (Kongresi i Manastirit).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit i njohin dy dialektet dhe diskutojnë për bazën dialektore të gjuhës letrare shqipe dhe vijnë në përfundim se gjuha letrare shqipe është krijuar me shkrirjen e dy dialekteve dhe sjellin shembuj me –ue- p.sh. i lexueshëm, i kuptueshëm (në gegërisht.), që në toskërishte i përgjigjet një –ua- p.sh. punuar, lexuar etj.</li> <li>- Dëgjojnë, flasin dhe ushtrojnë rreth degëve të gjuhësisë, njohin fonetikën si shkencë për studimin e tingujve të një gjuhe, ushtrojnë lidhur me përdorimin dhe ndryshimin e tingujve.</li> <li>- Ushtrojnë alfabetin sipas rendit të caktuar, njohin bazën latine të alfabetit të gjuhës shqipe, bëjnë krahasime të zgjidhjeve fonematike me gjuhët e huaja, mësojnë dhe hulumtojnë për Kongresin e Manastirit të vitit 1908.</li> <li>- nxënësit nyjetojnë vetë tingujt dhe vijnë në përfundim se sipas mënyrës së nyjetimit ato ndahen në zanore dhe bashkëtingëllore...;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjuha letrare, normat dhe standardizimi i saj</li> <li>- Baza dialektore e gjuhës letrare shqipe</li> <li>- Gjuhësia dhe degët e saj: fonetikë e fonologji (tingujt, fonemat)</li> <li>- Alfabeti i gjuhës shqipe;</li> <li>- Sistemi tingullor; ndarja e tingujve</li> </ul>	<p>Histori, Gjeografi,</p> <p>Histori,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- aftësohen për të njohur objektin e studimit të morfologjisë, për ta konkretizuar e zbatuar në praktikë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësit njihen me morfologjinë si degë e gjuhësisë (pjesë e gramatikës), pyesin, përgjigjen për prejardhjen e fjalës, njohin objektin e studimit;</li> <li>- shënojnë fjalë të ndryshme, ose marrin nga teksti, dallojnë formimin e tyre, kuptimin gramatikor si pjesë e ligjëratës, ushtrojnë me fjali, njohin funksionin e tyre në sintaksë, lidhshmërinë e tyre;</li> <li>- zbërthejnë fjalën në morfema, morfemat në fonema, shënojnë fjalë me një morfemë (ndajfolje, parafjalë, lidhëza,... përemra ), analizojnë fjalë të ndryshme, ndërtimin e tyre (rrënja, parashtesa, prapashtesa, mbaresa, tema);</li> <li>- ushtrojnë rreth formave të ndryshme të morfemave etj.</li> <li>- Dëgjojnë, shënojnë, pyesin duke u njohur me sintaksën, me objektin e studimit të saj;</li> <li>- ushtrojnë rregullat e bashkimit të fjalëve, krijojnë në mënyrë të pavarur togfjalësha, llojet e togfjalëshave, bashkojnë togfjalëshat në fjali dhe fjalitë në periudha;</li> <li>- gjejnë togfjalësha në fjali, në tekst, dallojnë lidhjen e tyre;</li> <li>- formulojnë përkufizimin për sintaksën, dëgjojnë njëri-tjetrin, komunikojnë dhe vlerësojnë...;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Morfologji, fjala, formimi i fjalëve, morfema</li> </ul>	<p>Arti figurativ,</p>



Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëllimi operativ është që të zhvillojë te nxënësit aftësinë e të dalluarit të sintaksës si degë e gramatikës.</li> <li>- Të zhvillojë aftësinë për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit dhe rregullave të tjera të drejtshkrimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- pyesin dhe vetë hulumtojnë për fjalën, leksikologjinë, për prejardhjen e saj, për objektin e studimit dhe lidhjen e saj me degët e tjera të gjuhësisë si fonetikë, morfologji etj.;</li> <li>- ushtrojnë kuptimin parësor e dytësor të fjalëve etj.</li> <li>- Lexojnë tekste, dëgjojnë, dallojnë intonacionin, pauzat, theksin, shënojnë fjali të ndryshme që i kanë dëgjuar nga teksti i lexuar apo i krijojnë vetë;</li> <li>- shënojnë qartë, krijojnë mirë mendimin, përdorin drejt shenjat e pikësimit, shkronjën e madhe, analizojnë, sintetizojnë, korrigjojnë njeri-tjetrin dhe vlerësojnë; përdorin fjalorin drejtshkrimor dhe përvetësojnë rregullat e drejtshkrimit</li> <li>- Nxënësit nxiten nga mësimdhënësi, dëgjojnë, vërejnë dhe flasin,</li> <li>- përpilojnë teza të shkurtra me shkrim, përgatiten për të folur drejtpërdrejt para shokëve për të treguar ndonjë ngjarje të dëgjuar, të lexuar, të shikuar, të përjetuar apo të imagjinuar;</li> <li>- tregojnë dhe ritregojnë duke veçuar momentet më emocionuese, krijojnë mbresat e veta, diskutojnë;</li> <li>- bëjnë planin, formulojnë tezat për të bërë një tregim, krijojnë mendimin e përbashkët në grupe të vogla, diskutojnë rreth punës së grupeve;</li> <li>- intervistojnë njëri-tjetrin, bashkëbiseduesin;</li> <li>- flasin për tekstet letrare dhe jo letrare, ushtrojnë për format e ndryshme të komunikimit të përditshëm;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sintaksë, përkufizimi</li> <li>- leksikologji</li> <li>- Drejtshkrim</li> </ul>	<p>Arti muzikor,Arti figurativ,</p> <p>Histori,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi të aftësohet për të dëgjuar, vërejtur, për të folur dhe përmbledhur mirë mendimin, për të folur pa emocione, për të bërë pauza, për të argumentuar me fakte;</li> </ul> <p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përcjellë me vëmendje bisedën e shokëve, të vlerësojë, të aftësohet për të komentuar, krijuar dhe gjykuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësit formulojnë reklama, lajme, lajmërimë, raporte;</li> <li>- bëjnë përshkrime të objekteve, vendeve, vizatimeve, fotografive etj.</li> </ul> <p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësi i nxit nxënësit për të shkruar, zgjedh temën ose e zgjedhin nxënësit;</li> <li>- bëjnë pikat e planit, rrjedhën e veprimit, hartojnë;</li> <li>- shkruajnë për ngjarje të vërteta, për tekstin e lexuar, për ngjarje të dëgjuara të përjetuara, të imagjinuara, shkruajnë tekste shkencore e publicistike me tema nga fusha të ndryshme;</li> <li>- shkruajnë biografi, autobiografi, reportazhe, ditarë, procesverbale;</li> <li>- bëjnë përshkrime të objekteve, rrethit, personazheve;</li> <li>- shkruajnë raporte, lajme, lajmërimë, bëjnë intervista, zgjedhin punimet më të mira, diskutojnë dhe vlerësojnë bashkë me mësimdhënësin.</li> </ul>	<p>2.</p> <p>Kulturë e të shprehurit me gojë</p>	<p>Histori, Gjeografi,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zhvillojë te nxënësi kulturën e të shkruarit të bukur, të shkruarit artistik me hyrje, përmbajtje e përfundim;</li> <li>- të zhvillojë aftësinë për të shkruar në mënyrë të pavarur tekste letrare dhe jo letrare për nevojat e veta dhe më gjerë;</li> <li>- të zhvillojë të menduarit dhe të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje të reja. Të shkruajë në gjuhën letrare, të përdorë drejt shenjat e pikësimit, të aftësohet për një shtjellim të thukët, të lidhur, të sistemuar e logjik.</li> </ul> <p><b>II. MËSIMI I LETËRSISË</b></p> <p>1. Të zhvillojë dashurinë për letërsinë qoftë popullore apo e shkruar, të motivojë nxënësit për punë, kërkim e krijim;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të aftësojë nxënësit për të vlerësuar dhe ruajtur trashëgiminë popullore si thesar i paçmuar i një populli</li> </ul>	<p>Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, pyesin dhe shënojnë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin tekstin letrar dhe jo letrar, tekstin popullor dhe atë të shkruar, bëjnë dallimin, mbledhin krijime popullore dhe i lexojnë në klasë, bisedojnë për rëndësinë e tyre, bëjnë dallimin e tekstit popullor sipas gjinisë dhe formës së të shkruarit,</li> <li>- mësojnë rolin e letërsisë si formë e njohjes dhe e vlerësimit, letërsinë si shkencë dhe degët e saj (historia e letërsisë, teoria e letërsisë dhe kritika letrare), pastaj bëjnë krahasimin e letërsisë si art me artet e tjera.</li> </ul> <p>1.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit dëgjojnë dhe lexojnë tekstin, analizojnë tekstin e lexuar, personazhet;</li> <li>- gjejnë motivin, mesazhin;</li> <li>- bëjnë krahasime me tekste të tjera të ngjashme;</li> <li>- flasin për temën, idenë, kompozicionin;</li> <li>- njohin gjininë letrare (epike, lirike), gjejnë në tekst figurat e stilit poetik;</li> <li>- njohin veprën letrare (prozë, poezi);</li> <li>- vargëzojnë rreshtat në vargje dhe anasjelltas, dallojnë veçoritë e vargut (llojet e tij) dhe të rreshtit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kulturë e të shprehurit me shkrim</li> </ul> <p><b>II. MËSIMI I LETËRSISË</b></p> <p>1. Autorë e vepra të propozuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje në veprën letrare dhe nocionet teorike-letrare</li> <li>- Nocioni, kuptimi, letërsia gojore dhe e shkruar, roli i letërsisë;</li> <li>- shkenca e letërsisë.</li> </ul> <p>- A. Z. Çajupi: <i>Kurbeti</i></p>	<p>Arti muzikor</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit aftësohen për të lexuar rrjedhshëm, bukur e me logjikë, për të vlerësuar tekstin letrar, për të njohur llojin e tij, për të përjetuar bukurinë e rolin e figurave poetike, për të dalluar motivet dhe plagët shoqërore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lexojnë tekstin lirik, hulumtojnë në fjalor prejardhjen e fjalës lirikë;</li> <li>- njohin veçoritë e lirikës si gjini letrare, flasin për të, përthurjen e bukur, për rendin e fjalëve në varg;</li> <li>- njohin llojin e lirikës (popullore dhe të shkruar), bëjnë krahasime, njohin llojet e tyre sipas motiveve që trajtojnë etj.</li> </ul>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësojë nxënësit për të njohur veçoritë e lirikës dhe llojet e saj, të dallojë gjuhën dhe të aftësohet për të vlerësuar, krijuar e gjykuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohin dhe flasin për veçoritë e epikës, llojet e saj, ecurinë e rrëfimit, lexojnë dhe flasin për subjektin, bëjnë dallimin e llojeve të epikës;</li> <li>- dallojnë temën, motivin flasin për to, për fabulën, analizojnë personazhet;</li> <li>- karakteristikat e tyre, veset dhe virtytet, flasin për kompozicionin, për gjuhën dhe stilin e përdorur etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veçoritë e gjuhës së veprës letrare;</li> <li>- stili figurativ (vargu, proza)</li> </ul>	Histori
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësojë nxënësit për të njohur veçoritë e epikës, të zhvillojë aftësinë për të çmuar, dashur e kultivuar të gjitha llojet e gjinisë epike popullore dhe të shkruar, të dallojë fazat dhe etapat e zhvillimit të ngjarjes, karakteret e personazheve, për të dalluar të veçantën nga e përgjithshmja, për të nxjerrë mesazhin kryesor, për të dalluar objektin e pasqyrimin dhe idenë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lexojnë dramën, bisedojnë për mbresat e fituara, analizojnë ngjarjen që zhvillohet nëpër mes të dialogëve, akteve;</li> <li>- analizojnë personazhet, bëjnë dallimin e personazheve pozitive dhe negative, veprimet e mira dhe jo të mira, flasin për shkakun dhe pasojën;</li> <li>- i luajnë vetë rolet në klasë, identifikojnë personazhin,</li> <li>- njohin llojet e gjinisë dramatike (komedinë, tragjedinë);</li> <li>- bëjnë dallimin në mes të dramës së shkruar dhe asaj që shohin në skenë;</li> <li>- filmojnë pjesë dramatike, vërejnë mundësitë që na ofron kamera etj.;</li> <li>- gjejnë të dhëna për autorin dhe veprat e tij;</li> <li>- njohin llojet e dramës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lirika (nacioni, veçoritë)</li> <li>- Llojet e lirikës</li>   <li>- Epika, llojet e saj</li> </ul>	Histori, Arkeologji, Gjeografi

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësojë nxënësit për të vërejtur dallimet në mes të gjinive dramatike dhe llojeve, për të kultivuar dhe nxitur prirjet e tyre për aktrim.</li> <li>- Nxënësit aftësohen për të njohur karakteristikat e llojeve të përziera, të përbashkëtën dhe të veçantën e tyre si dhe elementin letrar dhe shkencor.</li> <li>- Aftësohen për të studiuar, vlerësuar dhe gjykuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohin karakteristikat e llojeve të përziera, lexojnë dhe analizojnë pjesë të tilla në klasë si:biografi, memoare, udhë përshkrime, fejtone, ese etj,</li> <li>- ushtrojnë dhe shkruajnë vetë krijime të tilla të përziera letrare - shkencore.</li> <li>- Lexojnë, dëgjojnë dhe mbajnë shënime;</li> <li>- përdorin literaturë të ndryshme, gjurmojnë në bibliotekë etj.</li> <li>- Dëgjojnë dhe flasin për letërsinë e kohës së vjetër, për karakteristikat e saja, për fillimet, lashtësinë.</li> <li>- Lexojnë fragmente nga epi, analizojnë, bëjnë dialog në orë për përshtypjet;</li> <li>- bëjnë krahasime, njohin dhe flasin për karakteristikat e epit, dallojnë temën, idenë, motivet dhe personazhet dhe porosinë që del nga vepra.</li> <li>- Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, ose rrëfejnë vetë mite që i kanë dëgjuar, bëjnë krahasimin e tyre me pjesët letrare, bisedojnë për mitin, për gjerat dhe veprimet reale dhe joreale.</li> <li>- Nxënësit dëgjojnë, mbajnë shënime dhe lexojnë për fillimet e zhvillimit të letërsisë antike, për fazat e saj, për tematikën e veprave etj.</li> </ul>	<p><i>Mbeçë,more shokë,mbeçë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Petro Marko - <i>Varfëria</i></li> <li>- F. Postoli- <i>Lulja e kujtimit</i></li> <li>- K. Jakova - <i>Halili e Hajrija</i></li> <li>- Drama</li> </ul>	<p>Histori, Arti figurativ</p> <p>Histori, Gjeografi</p>



Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zgjojë interesimin për të lexuar, njohur, komentuar, për të mësuar përmendsh pjesë nga librat e shenjtë, për të njohur vlerën etike e edukative dhe për t'i vënë në jetë porositë e tyre.</li>   <li>- Të shtojë dashurinë për gjuhën e rëndësinë e saj, aftësinë dhe interesimin për të hulumtuar lashtësinë, dokumentet e vjetra zhvillimin dhe ndryshimet .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit njihen me zhvillimin, llojet dhe karakteristikat e letërsisë popullore, nxiten që të lexojnë krijime nga lirika popullore, të deklamojnë pjesë të mësuar më parë, të dallojnë të përbashkëtën, por edhe të veçantën e tyre (këngët e djepit, të dashurisë, të dasmës...etj.</li> <li>- Të gjejnë figurat poetike në shembuj.</li> <li>- Nxënësit njihen me epikën popullore në vargje, bëjnë dallimin e saj nga lirika, njohin karakteristikat e vargut, motivin, mjetet shprehëse, njohin llojet e tyre, diskutojnë për vjetërsinë e tyre; (Martesa e Halilit, Gjergj Elez Alia, Kënga e Aga Ymerit).</li> <li>- Nxënësit dëgjojnë dhe lexojnë pjesë nga këngët liriko-epike, dallojnë elementin lirik dhe epik (I ra megjulla Bunës).</li>   <li>- Nxënësit lexojnë prozë popullore, përrallën – Mbreti e plaku; analizojnë personazhet, vërejnë mençurinë e njeriut të thjeshtë, bëjnë krahasimin e përrallës me përralla të tjera, vërejnë përfundimet pozitive të tyre etj.</li> <li>- Lexojnë pleqërinë popullore - Lëkura e dhelprës, analizojnë pjesën, njohin vlerat e njeriut të thjeshtë, urtësinë dhe mençurinë.</li> </ul>	<p>Miti dhe letërsia</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Antika,</li> <li>- Fillet, zhvillimi i letërsisë</li> <li>- Homeri: <i>Iliada</i> (6) <i>Odisea</i></li>   <li>- Sofokliu: <i>Antigona</i> (frag)</li>   <li>- Teatri antik,</li>     <li>- Librat e shenjtë</li> <li>- Bibla,</li> <li>- Kurani</li> </ul>	<p>Histori, Art figurativ, Art muzikor</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zhvillojë tek nxënësit dashurinë dhe interesimin për krijimtarinë popullore - lirikën dhe epikën t'i motivojë për punë (kërkim e krijim),</li> <li>- Të aftësohen për të dalluar figurat e stilit poetik, përsëritjet, funksionin e tyre dhe fuqinë që i japin shprehjes poetike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit njihen nga mësimdhënësi me nocionin, karakteristikat dhe rolin e lëvizjes së gjerë kulturore, nxiten që të bëjnë krahasime të epokës së humanizmit me epokat tjera, njohin veçoritë kryesore të humanizmit, vendin e paraqitjes, përfaqësuesit dhe ndikimin që kanë pasur te krijuesit e tjerë.</li> <li>- Lexohen fragmente nga veprat e lexuara, komentohen dhe njihen me vlerat e përhershme të veprave dhe autorëve.</li> <li>- Nxënësit njihen me humanistët shqiptarë: Gjon Gazulli, Leonik Tomeu, Marin Beçikemi, me veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme, veçanërisht lexojnë dhe njohin Marin Barletin dhe veprën e tij Historia e Skënderbeut, me lëndën historike të saj dhe vlerën letrare e monumentale tek ne dhe popujt e tjerë.</li> </ul>	<p>Fillimet e shkrimit shqip:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formula e pagëzimit,</li> <li>- Fjalori i A. V. Harfit,</li> <li>- Ungjilli i Pashkëve</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Letërsia popullore</li> <li>- Lirika popullore</li> </ul>	<p>Histori e kohës së Skënderbeut,</p> <p>Histori,</p> <p>Histori, Gjeografi,</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësojë nxënësit për të bërë dallimin në mes të prozës popullore dhe asaj të shkruar, të dallojë karakteristikat e saj dhe llojet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit njihen me veçoritë, përfaqësuesit e letërsisë së vjetër, lexojnë fragmente nga veprat e tyre, bëjnë dallimin në mes tyre, analizojnë gjuhën e veprave, karakterin fetar dhe vlerën e madhe historike të tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Epika popullore në vargje</li>   <li>- Këngët liriko-epike</li> </ul>	<p>Histori</p>



Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit aftësohen të perceptojnë kohën dhe rrethanat e paraqitjes së Humanizmit dhe Rilindjes si lëvizje e gjerë kulturore, aftësohen që të njohin veçorinë kryesore - dashurinë e madhe ndaj njeriut, jetës dhe veprimtarisë së tij.</li>   <li>- Aftësohet për të njohur dhe dalluar karakterin fetar të letërsisë së vjetër shqipe dhe karakterin laik të letërsisë së bejtexhinjve.</li>   <li>- Nxënësi aftësohet për të dalluar epokat Humanizmin dhe Barokun dhe përfaqësuesit e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njihen me veçantitë e letërsisë së Bejtexhinjve, lexohen pjesë nga krijimet e tyre, dallojnë gjuhën e rënduar me orientalizma, motivin social dhe karakterin laik.</li>   <li>- Nxënësit njihen me barokun si drejtim i ri letrar me një stil të veçantë, me kohën e paraqitjes, me përfaqësuesit, krahasojnë barokun me klasicizmin, lexojnë pjesë dhe i komentojnë duke i krahasuar me pjesët e shikuara teatrale dhe diskutojnë rreth veseve dhe pasioneve të personazheve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Proza popullore</li>   <li>- Humanizmi dhe renesanca</li>   <li>- Dante - <i>Ferri</i> - frag.</li> <li>- F.Petrarka - <i>Kanconieri</i>-frag.</li> <li>- Bokaçio - <i>Dekameroni</i></li> <li>- Shekspiri - <i>Romeo dhe Zhuljeta</i></li> <li>- Servantesi- <i>Don Kishoti</i>,frag.</li> <li>- M. Dêrzhik- <i>Dundo Maroje</i></li>   <li>- Humanizmi te shqiptarët</li>   <li>Letërsia e vjetër shqipe</li> <li>- Gj. Buzuku - <i>Meshari</i></li> <li>- L. Matrënga - <i>E mbsuame e krishterë</i></li> <li>- P. Budi - <i>Vjershëtor e përkthyes</i></li> <li>- F. Bardhi - <i>Leksikograf</i></li> <li>- P. Bogdani - <i>Kënga e Sibilave</i></li> </ul>	<p>Histori, Art figurativ,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësojë nxënësit që të dallojnë vlerat e përhershme të veprave të detyrueshme.</li> <li>- Të aftësojë nxënësit për të lexuar, analizuar, vlerësuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Letërsia e bejtexhinjve</li> <li>- H. Z. Kamberi</li> <li>- Baroku e Klasicizmi</li> <li>- Moliere – <i>Koprraci</i> - frag.</li> <li>- Gunduliqi - <i>Osmani</i></li> </ul>	Arti figurativ
		Vepra të detyrueshme (kanone) <ul style="list-style-type: none"> <li>- M. Barleti - <i>Historia e Skënderbeut</i>,</li> <li>- Gj. Buzuku - <i>Meshari</i></li> <li>- Moliere - <i>Koprraci</i></li> </ul>	Histori
		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lektyrë shtëpie (e propozuar)</li> <li>- Sofokliu - <i>Antigona</i></li> <li>- Shekspiri - <i>Hamleti</i></li> <li>- Jakov Xoxe - <i>Lumi i vdekur</i></li> <li>Gj. Fishta- <i>Mrizi i zanave</i></li> </ul>	Histori, Gjeografi, Arti muzikor
			Histori
			Histori, Gjeografi, Art figurativ dhe muzikor
			Histori, Gjeografi,

**Lektyrë shtëpie (e propozuar)**

- Sofokliu: “*Antigona*”
- Shekspiri: “*Hamleti*”
- Jakov Xoxe: “*Lumi i vdekur*”
- Gj. Fishta: “*Mrizi i zanave*”

**KLASA II**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p><b>MËSIMI I GJUHËS</b></p> <p>1. Nxënësit t'i aftësojë që të përdorin gjuhën letrare, të ngrihet vetëdija për rëndësinë e Gjuhës letrare dhe dallimin e saj nga të folmet dialektore.</p> <p>- Të aftësojë nxënësit në përdorimin e drejtë të pjesëve të ligjëratës në trajta të ndryshme, të zgjerojnë horizontin e njohurive dhe të pasurojnë fjalorin.</p>	<p>1. Nxënësit dëgjojnë, lexojnë për historikun e shkurtër të rrugës së formimit të gjuhës letrare shqipe, për normat e gjuhës letrare, karakterin fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor, ortoepik etj.</p> <p>- Dëgjojnë, mbajnë mend dhe komentojnë.</p> <p>Nga tekstet kthejnë në normë letrare fjalët jonormative.</p> <p>- Nxënësit dëgjojnë, mbajnë mend dhe dallojnë në shembuj llojet e fjalëve të ndryshueshme e të pandryshueshme, me qëllim që të mësohet më lehtë visari leksikor i gjuhës.</p> <p>- Mësimdhënësi i nxit nxënësit të përdorin gjithë njohuritë paraprake që kanë marrë më parë, për të dalluar lakimin prej zgjedhimit.</p> <p>- Nxënësit ushtrojnë në shembuj dhe në tekst për pjesët e pandryshueshme dhe funksionin shërbyes të tyre në fjali.</p>	<p><b>I. MËSIMI I GJUHËS</b></p> <p>1. Gjuha letrare:</p> <p>- Historiku i rrugës së formimit të gjuhës letrare shqipe;</p> <p>- Parimet themelore të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe.</p> <p>Morfologji:</p> <p>- Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (emri, mbiemri, përemri, numërori dhe folja),</p> <p>- Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma)</p>	<p>Histori (shek. XVI-XX)</p> <p>Arti figurativ,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësohen që të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit dhe të aftësohen në përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit.</li> <li>- Nxënësi aftësohet;</li> <li>- për të dëgjuar, vërejtur, për të folur dhe përmbledhur mirë mendimin, për të folur pa emocione, për të bërë pauza, për të argumentuar me fakte;</li> <li>- të përcjellë me vëmendje bisedën e shokëve, të zhvillojë mendimin kritik,të komentojë dhe gjykojë.</li> <li>- Të zhvillojë tek nxënësi aftësinë krijuese, për të shkruar në mënyrë të pavarur tekste letrare dhe jo letrare, për të bërë pikat e planit dhe tezat për një krijim më të gjerë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit dëgjojnë, lexojnë rregullat për drejtshkrimin e fjalëve, ushtrojnë vetë drejtshkrimin e fjalëve bashkë, ndaras e me vizë në mes, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimin e datave përdorimin e shkronjës së madhe duke përdorur fjalorë e doracakë drejtshkrimorë.</li> </ul>	<p>Drejtshkrimi</p> <p>Kulturë e të shprehurit me gojë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrëfimi,</li> </ul> <p>- Kulturë e të shprehurit me shkrim</p>	<p>Arti figurativ,</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<p><b>II. MËSIMI I LETËRSISË</b></p> <p>1. Të zhvillojë aftësinë për të lidhur fenomenet historike me zhvillimin e kulturës dhe letërsisë.</p> <p>- Të zhvillojë aftësinë për të vërejtur vlerat estetike në tekstet letrare.</p> <p>- Të zhvillojë aftësinë për të dalluar nivelin artistik të veprave romantike dhe epokave të kaluara.</p> <p>- Të zhvillojë aftësinë e të dalluarit e elementeve të romanit në vargje, të veçuarit e sonetit nga krijimet tjera në poezi.</p> <p>- Nxënësit të aftësohen që të vërejnë karakterin popullor të letërsisë romantike, qëndrimin e romantikëve ndaj të kaluarës sonë kombëtare, të hetojnë kohën e –Motit të madh – në veprat e romantikeve dhe të kuptojnë porosinë e dhënë.</p>	<p>1. Nxënësit dëgjojnë dhe nxiten për të folur për veprat e lexuara, personazhet.</p> <p>Rrëfejnë për ngjarjet e përjetuara, për ngjarjet e shikuara (film, teatër), tregojnë dhe ritregojnë në mënyrë të pavarur duke veçuar momentet më emocionuese.</p> <p>- Bëjnë përshkrimin e objekteve, vendeve , vizatimeve e fotografive.</p> <p>- Mësimdhënësi i nxit nxënësit për të shkruar, zgjedh temën, ose e zgjedhin vetë nxënësit, bëjnë pikat e planit, rrjedhën e veprimit, hartojnë.</p> <p>- Shkruajnë për ngjarje të vërteta e të imagjinuara, shkruajnë tekste shkencore e publicistike nga lëmenj të ndryshëm, shkruajnë lloje të përziera letrare (biografi, autobiografi, ditar) etj.</p> <p>- Shkruajnë shkresa zyrtare dhe përdorin kulturën e gjuhës në praktikë (lutje ose kërkesë, ankesë, letër private ose zyrtare etj).</p>	<p><b>II. MËSIMI I LETËRSISË</b></p> <p>1. Autorë e vepra të propozuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Iluminizmi,</li> <li>- Lëvizja iluministe në Evropë;</li> <li>- Veçoritë, roli i iluminizmit</li> <li>- Iluminizmi në Voskopojë;</li> <li>- Përfaqësuesit;</li> <li>- Teodor Kavalioti.</li> </ul> <p>- Romantizmi</p> <p>Nocioni, veçoritë, roli, poetika, karakteristikat e stilit,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet letrare;</li> <li>- Përfaqësuesit:</li> <li>- Bajroni, <i>Çajld Haroldi</i></li> <li>- P. P. Njegosh- <i>Kurora e maleve</i>-fragment.</li> </ul> <p>- Romantizmi në letërsinë shqipe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veçoritë, specifikat;</li> <li>- shoqëritë, shkollat dhe shtypi shqiptar.</li> </ul>	<p>Histori shek. XVIII)</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>- Të zhvillojë aftësinë për të dalluar realizmin nga romantizmi, karakterin më të thelluar popullor e demokratik, aftësohen për të vërejtur theksin më të dukshëm realist me elemente më të fuqishme kritike.</p> <p>- Aftësohen për të dalluar veçoritë e realizmit shqiptar nga realizmi evropian.</p>	<p>Tekstet, sipas mundësive punohen në orë me shpjegime të mjaftueshme të mësimdhënësit, duke vënë theksin te lëvizja letrare e Voskopojës, si pjesë përbërëse e lëvizjes së gjerë që zhvillohej në Ballkan nën ndikimin e iluminizmit perëndimor.</p> <p>- Nxënësit lexojnë të dhënat për autorët dhe veprimtarinë patriotike të tyre dhe bëjnë krahasimin e të dhënave të lexuara me filmin e shikuar.</p> <p>- Nxënësit dëgjojnë, lexojnë e komentojnë pjesë nga veprat e romantikëve, analizojnë të përbashkëtën dhe të veçantën e tyre, dallojnë stilin, lirikën si lloj, romanin në vargje, mësojnë dhe recitojnë në orë pjesë të zgjedhura.</p>	<p>Mbledhësit e folklorit shqiptar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Thimi Mitko</li> <li>- N. Veqilharxhi, <i>Fletë qarkorja</i></li> <li>- J. de Rada - <i>Këngët e Milosaos</i>;</li> <li>- G. Dara i Ri - <i>Kënga e sprasme e Balës</i>;</li> <li>- K. Kristoforidhi- <i>Gjahu i malësorëve</i>;</li> <li>- Naim Frashëri - <i>Bagëti e bujqësia - Lulet e verës</i>,</li> <li>- <i>Historia e Skënderbeut</i>,</li> <li>- Ndre Mjeda- <i>Andrra e jetës, Vaji i bylbylit</i>,</li> <li>- Filip Shiroka - <i>Një lules së vyshkun</i></li> </ul> <p>Realizmi,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nocioni, karakteristikat,</li> <li>- Poetika</li> <li>- Balzaku, <i>Evgjeni Grande</i></li> <li>- Gogoli - <i>Revizori</i></li> <li>- B. Nushiq - <i>Deputeti i popullit</i></li> </ul>	<p>Histori (koha e Ali Pashë Tepelenës), Gjeografi</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit aftësohen për të zbatuar njohuritë letrare teorike e historike në veprat e dhëna.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit njihen me veçoritë e romantizmit shqiptar, me të përbashkëtën dhe të veçantën e romantizmit evropian, njihen me figurat e shquara të Rilindjes kombëtare shqiptare, me veprimtaritë e tyre të larmishme, organizimin e shtypit, formimin e shoqërive, hapjen e shkollave në Gjuhën shqipe, përpjekjet për përpilimin e teksteve shkollore, përpjekjet e arbëreshëve për të ruajtur identitetin kombëtar me veprat e tyre letrare.</li> <li>- Nxënësit lexojnë dhe bëjnë dialog lidhur me motivet e veprave, porositë që dalin nga veprat.</li> <li>- Sjellin shembuj dhe komentojnë në klasë, recitojnë pjesë të zgjedhura nga mësimdhënësi ose sipas dëshirës.</li> <li>- Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, mbajnë mend dhe diskutojnë për realizmin e krahasojnë me romantizmin dhe dallojnë ndryshimet e mëdha në mes tyre;</li> <li>- lexojnë dhe flasin për tematikën e veprave, personazhet, llojet letrare që shkruhen në realizëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizmi në Letërsinë shqipe:</li> <li>- A.Z. Çajupi - <i>Mëmëdheu</i>, poezi, <i>Vaje</i></li> <li>- <i>Pas vdekjes</i>-frag.</li> <li>- Asdreni - <i>Luftari lypës</i>, - <i>Larg vatrës</i></li> <li>- A. Asllani- <i>Hanko Halla</i></li> <li>- M. Kuteli - <i>Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e zotit</i></li> <li>- Vepra të detyrueshme:</li> <li>- De Rada- <i>Këngë të Serafina Topisë</i></li> <li>- N. Frashëri - <i>Historia e Skënderbeut</i></li> <li>- Çajupi - <i>Baba Tomori</i></li> <li>- Petro Marko- <i>Sipas zgjedhjes</i></li> </ul>	<p>Histori, Gjeografi</p> <p>Histori (Shqipëria e shek XIX)</p> <p>Histori (shek.XIX)</p>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, mbajnë mend se realizmi në Letërsinë shqipe vjen një shekull më vonë se në letërsinë evropiane;</li> <li>- mësojnë shkaqet e një vonese të madhe të paraqitjes së realizmit tek ne;</li> <li>- mësojnë për karakteristikat e letërsisë realiste shqiptare, të përbashkëtën, por edhe të veçantën me realizmin evropian;</li> <li>- njihen me temat, motivet, llojet e shkrimeve, lexojnë, analizojnë dhe recitojnë pjesë nga realistët tanë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lektyrë shtëpie (e propozuar)</li> <li>- P. Vasa - <i>Bardha e Temalit</i></li> <li>- Heminguej - <i>Plaku dhe deti</i></li> <li>- R. Qosja - <i>Vdekja me vjen prej syve të tillë</i></li> <li>- Z. Hoxhiq- <i>Viti i Gucisë</i></li> </ul>	Histori (shek XX)

**Vepra të detyrueshme:**

- De Rada: *"Këngët e Serafina Topisë"*
- N. Frashëri: *"Historia e Skënderbeut"*
- Çajupi: *"Baba Tomori"*
- Petro Marko: Sipas zgjedhjes

**Lektyrë shtëpie (e propozuar)**

- P. Vasa: *"Bardha e Temalit"*
- Heminguej: *"Plaku dhe deti"*
- R. Qosja: *"Vdekja me vjen prej syve të tillë"*
- Z. Hoxhiq: *"Viti i Gucisë"*



**KLASA III****Tema: Gjuhë: fjalëformimi, leksikologji, sintaksë, drejtshkrim dhe kulturë e të shprehurit**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
1. Nxënësi di për formimin e fjalëve: di të formojë emra, mbiemra, folje me ndajshesa.	1. Nga shembujt e dhënë sqaron formimin e fjalëve; - bën ushtrime të drejtshkrimit në formimin e fjalëve; përmirëson gabimet.	1. GJUHË: formimi i fjalëve: emri, mbiemri, folja (parashtesa, prapashtesa)	Gjuhët e huaja
2.1/2.2/2.3. Nxënësi i njeh termat e leksikologjisë, njësitë leksikore, di të ilustrojë llojlojshmërinë leksikore.	2. Shfrytëzojnë bibliotekën, shfletojnë fjalorë  2.2. Shkruajnë dhe ushtrojnë për lidhjet mes leksemave sipas tekstit të zgjedhur.  2.3. Bëjnë ndërrimet e fjalëve në tekst dhe tregojnë për ndryshimet, vlerat stilistike e semantike të tyre; - zgjedhin fjalë dhe i përpunojnë ato duke u bazuar në tekst, fjalor etj. dhe e pasurojnë kuptimin e tyre.	2.1. Leksikologji (elementet terminologjike dhe frazeologjike).	
2.4. Nxënësi di për vlerat e fjalëve të huaja, kalkeve, arkaizmave, neologjizmeve, dialektizmeve, lokalizmeve; di të sqarojë fjalën purizëm.	2.4. Shfrytëzojnë bibliotekën, fjalorët; hartojnë fjalorthin e fjalëve të huaja, kalkeve, arkaizmave, purizmave, zhargonizmave, vulgarizmave, dialektizmeve, lokalizmave	2.4. Fjalët me prejardhje nga gjuhët e huaja dhe kalket (purizmi, arkaizmat, neologjizmat, dialektizmat, lokalizmat).	
2.5. Nxënësi di të dallojë sinonimet, homonimet, antonimet; di t'i përdorë ato.	2.5. Hartojnë fjalorth për sinonime, homonime, antonime	2.5. Sinonimet, homonimet dhe antonimet	
2.6/2.7. Nxënësi është i aftë të përdorë fjalorët e fjalëve të huaja dhe fjalorët terminologjike.	2.6/2.7. Shfrytëzojnë fjalorët e fjalëve të huaja dhe fjalorët terminologjik, hartojnë fjalorthët e tyre përkatës	2.6. Fjalorët e fjalëve të huaja	

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>3. Di ç'është fjalia, llojet e saj; - di të dallojë togfjalëshin; - di konstruktin e periudhës.</p>	<p>3. Njohin njësitë sintaksore; njohin tipat e fjalive në tekst, shkruajnë fjali të ngjashme, sqarojnë funksionin e tyre dhe vlerën stilistike, gjejnë shembuj në tekst, ushtrojnë shkrimin e fjalive dhe të periudhave, përmirësojnë gabimet.</p>	<p>3. Sintaksa:  Njësitë sintaksore: - togfjalëshi - fjalia - periudha</p>	<p>Gjuha latine (sintaksa e gjuhës latine dhe sintaksa e gjuhëve tjera të huaja)</p>
<p>4. Di të përdorë fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe për të mënjanuar gabimet drejtshkrimore.</p>	<p>4. Bëjnë ushtrime drejtshkrimore, hartojnë tekste, korrigjojnë gabime.</p>	<p>4. Drejtshkrimi</p>	
<p>5. Kupton fjalën transkriptim dhe transliterim; di të transkribojë fjalë nga gjuhë të huaja, di t'i përshtatë me natyrën e gjuhës shqipe.</p>	<p>5. Krahasojnë shembuj të teksteve të transkriptuara dhe të transliteruara vetë dhe me ndihmën e mësimitdhënësit, bëjnë përpjekje për transkriptim dhe transliterim.</p>	<p>5. Kulturë e të shprehurit  - të shprehurit me shkrim - stili publicistik, llojet: lajmi, raporti, intervista, - të shprehurit me gojë.</p>	<p>Gjuhët e huaja</p>
<p>6. Di të shkruajë lloje të ndryshme publicistike, di të paraqitet me fjalë dhe aftësohet që të flasë para nxënësve; - di të polemizojë dhe vlerëson bashkëbiseduesin; - di të komentojë dhe të respektojë mendimin e tjetrit</p>	<p>6. Ushetrojnë të shprehurit me shkrim të stileve të ndryshme; - përgatiten që të shprehen edhe me gojë, paraqiten para klasës dhe komentojnë tekstet e përgatitura.</p>		<p>Edukimi qytetar (analiza e teksteve nga gazetat)</p>

**KLASA III**

**Tema: Letërsi: Modernizmi në letërsinë evropiane, prirjet moderniste në letërsinë shqipe; Shkolla Letrare e Shkodrës, prirjet sociale dhe të tjera në letërsinë shqipe në gjysmën e parë të shekullit XX; modernizmi në letërsinë serbo-malazeze; nocione letrare (lirika, epika, drama)**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>1. Nxënësi di:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë ndryshimet në prosedeun poetik;</li> <li>- të gjejë asociacione dhe analogji;</li> <li>- të flasë për potencialin simbolik të vjershës;</li> <li>- të bëjë krahasim me prosedeun tradicional poetik;</li> <li>- të hetojë funksionalitetin e gjuhës poetike;</li> <li>- të flasë për probleme të ndryshme të epokës moderniste, dekadencën, pakënaqësinë me gjendjen ekzistuese;</li> <li>- të hetojë rëndësinë e bukurisë;</li> <li>- të sqarojë veçoritë e modernizmit evropian, shqiptar, malazias;</li> <li>- të sqarojë shkaqet e paraqitjes me vonesë të modernizmit në letërsinë tonë krahasuar me letërsinë evropiane;</li> <li>- të analizojë tekstin poetik;</li> <li>- të dallojë elementet tradicionale e moderne në tekstin poetik;</li> </ul>	<p>1. Nxënësit dëgjojnë dhe lexojnë tekste letrare;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- recitojnë vargje;</li> <li>- punojnë në grupe për të gjetur shtresat e tekstit letrar;</li> <li>- shënojnë asociacionet që ofron teksti poetik;</li> <li>- me shkrim dhe me gojë shprehin përjetimin e tyre;</li> <li>- më të talentuarit vizatojnë diçka si komentim të tekstit letrar;</li> <li>- gjejnë dhe klasifikojnë simbole;</li> <li>- në grupe punojnë për një ose më shumë personazhe nga teksti poetik;</li> <li>- krahasojnë rezultatet dhe argumentet;</li> <li>- diskutojnë për motivet e letërsisë moderniste;</li> <li>- bëjnë gara në recitimin e vargjeve;</li> <li>- shënojnë asociacione nga teksti poetik;</li> <li>- recitojnë pjesë të zgjedhura;</li> <li>- dëgjojnë recitime të teksteve letrare;</li> <li>- flasin për veprën si tërësi;</li> </ul>	<p>1. Letërsia moderne</p> <p>Letërsia moderne evropiane (drejtimet kryesore)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sh . Bodleri: <i>Albatrosi</i></li> <li>- E.A. Po: <i>Korbi</i></li> <li>- Dostojevski: <i>Krimi e dënimi</i> (fragment)</li> </ul>	<p>1. Historia (gjysma e dytë e shekullit XIX)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- arti figurativ, arti muzikor (drejtimet moderne në këto arte)</li> </ul>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të hetojë variante të motiveve tradicionale;</li> <li>- të bëjë krahasime me autorët që i ka mësuar më parë;</li> <li>- të hetojë elementet moderne në tekste letrare (poezi, prozë, dramë);</li> <li>- të kuptojë mundësinë e shfrytëzimit të folklorit;</li> <li>- të flasë në mënyrë kritike për lirinë, për temat tabu dhe të ndaluara;</li> <li>- të flasë në mënyrë kritike për problemet e familjes, për egoizmin, narcisoizmin etj...;</li> <li>- të gjejë vetë pika të ngjashme në kuadër të modernizmit;</li> <li>- të hetojë në mënyrë të pavarur mundësi të reja që ofrojnë figurat stilistike, vargu, ritmi...</li> <li>- të shfrytëzojë njohuri teorike për analizë;</li> <li>- të dallojë elemente të veçanta të drejtimeve letrare moderniste;</li> <li>- të vështrtojë veprën letrare nga aspekti biografik, psikologjik, sociologjik;</li> <li>- të shfrytëzojë drejt metaforat në veprat letrare për të shtjelluar probleme jetësore (personalitetin, të huajsimin, egoizmin);</li> </ul>	<p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- punojnë në grupe për të gjetur figurat letrare me të cilat përshkruhen personazhet etj.;</li> <li>- hartojnë punimin duke përshkruar natyrën ose ndonjë gjendje të caktuar emocionale;</li> <li>- flasin për veprën letrare;</li> <li>- përdorin Fjalorin terminologjik letrar (gjejnë informata të caktuara);</li> <li>- shikojnë filma për Bodlerin dhe autorë të tjerë të modernizmit evropian;</li> <li>- shikojnë incizime për Lasgush Poradecin, Nolin, Gj. Fishtë, F. Konicën dhe autorë të tjerë shqiptarë të gjysmës së parë të shekullit XX;</li> <li>- veçojnë thelbësoren nga ajo që kanë lexuar;</li> <li>- analizojnë tekste poetike me ndihmën e mësimitdhënësit;</li> <li>- bëjnë detyrat hulumtuese;</li> <li>- komentojnë punën e tyre hulumtuese;</li> <li>- diskutojnë në orë për punët e përgatitura;</li> <li>- lexojnë detyrat e shtëpisë;</li> <li>- në grupe kërkojnë figura stilistike në tekste letrare;</li> </ul>	<p>2. Letërsia shqipe në gjysmën e parë të shekullit XX</p> <p>2.1. Prijet moderniste në letërsinë shqipe në këtë periudhë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- L. Poradeci: <i>Vdekja e Nositit</i></li> <li>- F. Noli: <i>Shën Pjetri në mangall</i></li> <li>- Sterjo Spasse: <i>Pse</i> (fragment)</li> </ul> <p>2.2. Shkolla letrare e Shkodrës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndoc Nikaj: <i>Bukuroshja</i> (fragment)</li> <li>- Shtjefën Gjeçovi: <i>Kanuni i Lekë Dukagjinit</i> (fragment)</li> </ul>	<p>2. Historia (historia shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XX)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- arti figurativ, arti muzikor, teatri</li> </ul>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të hetojë dhe të zgjedhë figura letrare;</li> <li>- të kuptojë problemin e këndvështrimit në veprën narrative;</li> <li>- të sqarojë strukturën lirike/epike të veprës;</li> <li>- ka aftësi për të zhvilluar e krijuar asociacione;</li> <li>- të sqarojë domethënien dhe funksionin e lajtmotivit dhe ta zbatojë për personazhe të ndryshme dhe situata të ndryshme jetësore;</li> <li>- të sqarojë veçoritë e drejtimeve letrare moderniste;</li> <li>- të paraqesë strukturën e poezisë, tregimit;</li> <li>- të zbatojë njohuritë e deritashme për dramën;</li> <li>- të sqarojë funksionalitetin e shenjave skenike;</li> <li>- di ç'është stil i mirë;</li> <li>- të hetojë funksionalitetin e figurave stilistike, kompozicionet, strofës, vargut, rimës.</li> </ul>		<p>2.3. Prirja sociale në letërsinë shqipe gjatë viteve të tridhjeta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Migjeni: <i>Poema e mjerimit</i></li> <li>- Esad Mekuli: <i>Kush i pari bani</i></li> <li>- Haki Stërmilli: <i>Sikur t'isha djalë</i> (fragment)</li> </ul> <p>2.4. Prirjet tjera në letërsinë shqipe gjatë viteve të tridhjeta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faik Konica: <i>Doktor Gjilpëra</i> (fragment)</li> </ul> <p>3. Letërsia malazeze</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- J. Duçiq: <i>Luledielli</i></li> </ul>	<p>3. Historia serbo- malazeze e gjysmës së parë të shekullit XX</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- arti figurativ, arti muzikor</li> </ul>

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nacionet e përmbajtja	Korelacionet
		<p>4. Nociione letrare</p> <p>4.1.Lirika: Lirika moderne</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vjersha në prozë</li> <li>- vargu</li> <li>- strofa</li> </ul> <p>4.2. Epika</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- narracioni</li> <li>- dialogu</li> <li>- monologu</li> </ul> <p>4.3. Drama moderne (psikologjike, simboliste, impresioniste)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjuha skenike</li> <li>- publiku</li> <li>- aktori</li> <li>- aktrimi</li> <li>- skenografi</li> <li>- regjisori</li> </ul> <p>Lektyrë shtëpie</p> <p>Gëte: <i>Vuajtjet e Vërterit të ri</i>  Ali Podrimja: <i>Drejtpehimi</i>  Ernest Koliqi: <i>Shija e bukës së mbrume</i>  Dritëro Agolli: <i>Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo</i></p>	<p>4. Arti muzikor, teatri</p>

**Autorët dhe veprat e domosdoshme (kanonet)**

- Sh. Bodler: *“Albatrosi”*
- L. Poradeci: *“Vdekja e Nositit”*
- N. Mjeda: *“Liria”*
- Gj. Fishta: *“Juda Makabe”*
- E. Koliqi: *“Shija e bukës së mbrume”*

**Lektyrë shtëpie**

- Gëte: *“Vuajtjet e Vërterit të ri”*
- Ali Podrimja: *“Drejtpehimi”*
- Ernest Koliqi: *“Shija e bukës së mbrume”*
- Dritëro Agolli: *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*

**KLASA IV****Tema: Gjuhë; sintaksë, drejtshkrim, kulturë e të shprehurit**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>1. Nxënësi di:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë qartë llojet e fjalive dhe të periudhave nga teksti i dhënë;</li> <li>- është i aftë që në mënyrë të pavarur të korrigjojë tekstin;</li> <li>- është i shkathhtë të sistemojë pjesë përbërëse të fjalisë;</li> <li>- shprehet drejt;</li> <li>- është i aftë të sistemojë periudhën e bashkërenditur dhe të nënrenditur;</li> <li>- është i aftë të shprehë qartë mendimin;</li> <li>- është i sigurt në të shprehur;</li> <li>- përdorë drejt fjalinë/periudhën;</li> <li>- njeh mirë kohët dhe mënyrat e foljes dhe pjesët e tjera të ligjëratës;</li> <li>- është i aftë të hetojë vlerat stilistike;</li> <li>- mund të shprehë mendimin në disa mënyra;</li> <li>- kupton rolin e gjuhës në sfera të ndryshme të jetës;</li> <li>- di të shkruajë forma të ndryshme të shprehjes.</li> </ul>	<p>1. Nxënësit përgatisin shembuj për fjalinë, periudhën dhe i hetojnë llojet e periudhave në tekstin e dhënë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizojnë shembuj nga tekstet;</li> <li>- formulojnë me shkrim e me gojë fjali të llojeve të ndryshme;</li> <li>- formulojnë me shkrim e me gojë fjali me periudha bashkërenditëse e nënrenditëse;</li> <li>- duke u nisur nga teksti formulojnë fjali e periudha të reja dhe saktësojnë tipin e fjalisë /periudhës të cilën kanë formuar;</li> <li>- hetojnë vlerat informative dhe stilistike të fjalive / periudhave të lexuara ose të formuara;</li> <li>- ushtrojnë rregullat drejtshkrimore;</li> <li>- dallojnë kohët dhe mënyrat e foljes dhe pjesët e tjera të ligjëratës si dhe rolin e funksionin e tyre në fjali/periudhë;</li> <li>- mënjanojnë nga tekstet e dhëna pjesët e tepërta të fjalisë/periudhës;</li> <li>- shkruajnë shembuj ku fjalinë/periudhën e shkurtojnë për të shprehur të njëjtin kuptim;</li> <li>- nxënësit shqiptojnë fjali/periudha veç e veç.</li> </ul>	<p>1.Gjuhë</p> <p>1.1. Periudha, fjalia: ndërtimi i periudhave, lidhjet e fjalive në periudhë (bashkërenditja, nënrenditja);</p>	<p>Gjuhët e huaja (angleze,italiane etj...), gjuha serbe</p> <p>Historia, sociologjia</p>



Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>1.2. Nxënësi di nocionin e përgjithshëm për gjuhën:</p> <p>për zhvillimin e shkrimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- është i aftë të dallojë familjet e gjuhëve në botë;</li> <li>- di për tolerancën gjuhësore në mjediset shumëgjuhëshe.</li> </ul>	<p>1.2. Nxënësit, së bashku me mësimdhënësin ushtrojnë për vlerat e përgjithshme të gjuhës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësit, në grupe ose individualisht, ushtrojnë veçoritë e zhvillimit historik të gjuhës amtare ose të ndonjë gjuhe tjetër;</li> <li>- nxënësit shikojnë emisione televizive për shkrimet e para të gjuhëve të ndryshme;</li> <li>- nxënësit ushtrojnë ndarjen e gjuhëve, familjet e gjuhëve në botë, ushtrojnë ngjashmëri gjuhësore;</li> <li>- flasin për tolerancën gjuhësore dhe ushtrojnë në grupe ose individualisht;</li> </ul>	<p>1.2. Nocione të përgjithshme për gjuhën: Zhvillimi i gjuhës, fillimi i shkrimit, gjuha dhe kategoritë e tjera shoqërore, dygjuhësia.</p>	Gjuhët e huaja
<p>1.3. Nxënësi di të përdorë drejt shenjat e pikësimit</p>	<p>1.3. Nxënësit ushtrojnë në grupe dhe individualisht drejtshkrimin e gjuhës shqipe dhe shenjat e pikësimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- korrigjojnë gabimet drejtshkrimore në tekst.</li> </ul>	<p>1.3. Drejtshkrimi: shenjat e pikësimit</p>	

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>2. Nxënësi njih stilet funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- di të shkruajë forma të stilit administrativ;</li> <li>- di të komentojë;</li> <li>- di të lektorojë dhe të stilizojë tekstin;</li> <li>- di të bëjë korrekturën e tekstit;</li> <li>- di të bëjë redaktimin;</li> <li>- është në gjendje të realizojë e vlerësojë çfarë ka dëgjuar;</li> <li>- është i aftë të flasë për atë çfarë ka parë dhe çfarë ka lexuar.</li> </ul>	<p>2. Shkruajnë detyra me shkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruajnë sipas modelit dhe teksteve të zgjedhura;</li> <li>- shkruajnë format e stilit administrativ (kërkesa, ankesa, procesverbal etj...);</li> <li>- shkruajnë informacione administrative (konkurs, shpallje, lajmërim etj...);</li> <li>- ushtrojnë analizën dhe sintezën;</li> <li>- përpiqen të shkruajnë ndonjë tekst më kompleks për probleme shoqërore, aktivitete shkencore nga jeta artistike etj.;</li> <li>- përkthejnë tekste nga gjuhët e huaja që mësojnë, pastaj i stilizojnë;</li> <li>- bëjnë lektorimin e teksteve;</li> <li>- bëjnë korrekturën;</li> <li>- lexojnë, dëgjojnë pjesë të zgjedhura nga oratoria dhe i komentojnë;</li> <li>- paraqiten me gojë para nxënësve dhe polemizojnë, gjatë paraqitjes përdorin shënime;</li> <li>- gjatë të folurit përdorin gjestet, mimikën dhe analizojnë ndikimin e tyre;</li> <li>- bisedojnë për ndikimin e medieve në tipin e ri të retorikës;</li> <li>- bisedojnë për shfaqje teatrale, për filmin, emisione televizive etj.</li> </ul>	<p>2.Kultura e të shprehurit:</p> <p>2.1.Të shprehurit me shkrim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vështrimi</li> <li>- diskutimi</li> <li>- eseja</li> <li>- stili administrativ</li> <li>- referati</li> <li>- kërkesa</li> <li>- procesverbali</li> </ul> <p>2.2.Të shprehurit me gojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lektorimi</li> <li>- korrektimi</li> </ul>	<p>2. Sociologjia (sociolinguistika)</p>

**KLASA IV**

**Tema: Letërsi: Metodologjia e studimit të letërsisë; letërsia shqipe, botërore e malazeze në gjysmën e dytë të shekullit XX, postmodernizmi**

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>1.1 Aftësia e lidhjes së dukurive letrare botërore në shekullin XX:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- aftësia e të kuptuarit e kaheve (drejtimeve) kryesore letrare në këtë periudhë;</li> <li>- aftësia e hetimit të ngjashmërive dhe dallimeve;</li> <li>- aftësia e zbulimit të vlerave artistike.</li> </ul>	<p>1. (1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4) gatishmëria që të punohet në grupe për vepra të caktuara letrare; biseda për personazhet, përgatitja për paraqitjen me gojë; paraqitja me gojë (krahasimi i paraqitjeve në klasë);</p>	<p>1. Letërsia në gjysmën e dytë të shekullit XX</p> <p>1.1 Letërsia botërore në gjysmën e dytë të shekullit XX:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- F. Kafka: <i>Procesi</i> (fragment)</li> <li>- A. Kamy: <i>I huaji</i> (fragment)</li> <li>- D. Buxati: (Zgjedhje)</li> </ul> <p>Markes: <i>Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë</i> (fragment)</p>	<p>Sociologjia</p> <p>Psikologjia</p> <p>Filozofia (metodat e këtyre shkencave si modele për studimin e veprës letrare)</p> <p>Arti muzikor</p> <p>Filozofia (ekzistencializmi)</p>
<p>1.2 Aftësia e të njohurit dhe të kuptuarit të letërsisë bashkëkohore shqipe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- aftësia e hetimit të prirjeve kryesore;</li> <li>- tërheqja e paraleleve me letërsitë e huaja;</li> <li>- njohja e vlerave letrare-estetike.</li> </ul>		<p>1.2 Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit XX</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Martin Camaj: <i>Rrungaja në mars</i></li> <li>- Kadare: <i>Prilli i thyer</i> (fragment)</li> <li>- M. Kraja: <i>Sëmundja e ëndrrave</i> (fragm.)</li> <li>- Fatos Kongoli: <i>Ëndrra e Damokleut</i> (fragment)</li> <li>- D. Mehmeti: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- Azem Shkreli: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- Xh. Spahiu: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- F. Arapi: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- Rr. Dedaj: <i>Jeta gabon</i> (zgjedhje)</li> <li>- Mimoza Ahmeti: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- Basri Çapriqi: <i>Poezi</i> (zgjedhje)</li> <li>- Anton Berishaj <i>Poezi</i> (sipas zgjedhjes)</li> </ul>	<p>Historia (shqiptare, malazeze dhe botërore në gjysmën e dytë të shekullit XX)</p> <p>Arti figurativ</p> <p>Edukimi qytetar</p>
<p>1.3 Njohja e vlerave letrare malazeze, toleranca.</p>		<p>1.3 Letërsia malazeze</p> <p>Jevrem Bërković: (Poezi sipas zgjedhjes)</p>	
<p>1.4 Aftësia e njohjes së vlerave të kritikës letrare të ne, njohja e prirjeve të kritikës letrare; shkrimi i kritikave të shkurtra dhe eseve.</p>		<p>1.4 Kritikë letrare bashkëkohore shqipe (Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, Aurel Plasari)</p>	

Qëllimet operative	Aktivitetet	Nocionet e përmbajtja	Korelacionet
<p>2.</p> <p>2.1. Aftësia e të kuptuarit të poezisë lirike, njohja e strukturës, gjuhës poetike, figuracionit</p> <p>2.2. Aftësia e njohjes së elementeve strukturore të prozës (tregimi, novela, romani)</p> <p>2.3. Zotërimi dhe të kuptuarit e strukturës së tekstit dramatik; njohja e teatrit, dallimet tekst dramatik-shfaqje teatrale / filmike</p> <p>3.</p> <p>3.1. Vetëdija për gjuhën amtare; aftësia e zbatimit praktik të gjuhës (sintaksë); toleranca gjuhësore; krahasimi i gjuhës amtare me gjuhët e huaja; aftësia e përdorimit të shenjave të pikësimit.</p> <p>4. Aftësia e të kuptuarit dhe realizimi praktik i të shprehurit me gojë dhe me shkrim</p> <p>4.1. Nxënësi di:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë njohuritë e arritura për t'i zbatuar për metodat në qasjen e veprës letrare</li> <li>- vlerëson veprën letrare</li> <li>- zbaton njohuritë metodologjike në studimin e veprës letrare</li> </ul>	<p>2. (2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4) paraqitja gojore dhe me shkrim për vepra, personazhi letrar, esetë; përdorimi i filmit për të bërë dallime mes formave artistike; analiza e veprave me ndihmën e arsimitarit; leximi i fragmenteve, dramatizimi i teksteve; shikimi i shfaqjeve teatrale dhe filmike</p> <p>3. (3.1, 3.2 dhe 3.3) leximi, dëgjimi, tregimi, argumentimi, diskutimi etj...</p> <p>4. Leximi, tregimi, interpretimi</p> <p>4.1. Nxënësi në mënyrë të pavarur punon me tekste letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në grupe hulumtojnë detyra të caktuara për vepra letrare</li> <li>- paraqesin rezultate të arritura</li> <li>- ilustrojnë qasjen e ndonjë metode</li> <li>- në mënyrë kritike vlerësojnë arritjet e tyre</li> </ul>	<p>2. Konceptet teorike-letrare</p> <p>2.1. Lirika: Të shprehurit lirik, krijimtaria lirike.</p> <p>2.2. Epika: Struktura e veprës artistike në prozë, narracioni objektiv e subjektiv, tregimtari fiktiv.</p> <p>2.3. Drama: Struktura dhe kompozicioni i dramës, drama dhe teatri, radio, televizioni, filmi.</p> <p>2.4. Udhë përshkrimi, eseja, kritika letrare</p> <p>3. Metodologjia e studimit të letërsisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- studimi i jashtëm dhe i brendshëm i veprës letrare;</li> <li>- metodat e studimit: pozitivizmi, fenomenologjia, strukturalizmi, formalizmi...</li> </ul> <p>Lekturë shtëpie</p> <p>Anton Pashku: <i>Sinkopa</i> Vath Koreshi: <i>Ulku dhe Uilli</i> Martin Camaj: <i>Rrathët</i> Xh. Xhojs: <i>Uliksi</i></p>	

**Autorët dhe veprat e domosdoshme (kanon)**

- Kamy: “*I huaji*”
- Gj. Fishta: “*Lahuta e Malcisë*”
- Kadare: “*Viti i mbrapshtë*”
- M. Camaj: “*Rrathët*”
- F. Kongoli: “*Ëndrra e Damokleut*”
- Andriq: “*Ura mbi Drinë*”
- V. Zhiti: “*Poezi*”
- Rr. Dedaj: “*Jeta gabon*”
- Pashku: “*Sinkopa*”

**Lekturë shtëpie**

- Anton Pashku: “*Sinkopa*”
- Vath Koreshi: “*Ulku dhe Uilli*”
- Martin Camaj: “*Rrathët*”
- Xh. Xhojs: “*Uliksi*”

**Diferenca e njësive mësimore për të arritur standardet**

Njësitë e mëposhtme mësimore janë të parapara për nxënësit që dëshirojnë të regjistrohen në universitet. Ato përfshijnë njësitë mësimore që janë të parapara për drejtimin e gjimnazit, por që nuk janë të përfshira në programet e kësaj lënde për shkollat profesionale

Njësitë janë të ndara në vite dhe emërtohen: shtojca për vitin e parë, shtojca për vitin e dytë, shtojca për vitin e tretë dhe shtojca për vitin e katërt.

**Shtojca për vitin e parë:**

1. Shtresat e gjuhës shqipe, argot, sociolektet
2. Variantet e fonemave
3. Drejtshkrimi
4. Enver Gjerqeku - *Sofra*
5. Versifikacioni

6. Lirika, nocioni, veçoritë
7. Migjeni - *Historia e njërës nga ato*
8. Miti trojan, epi antik, çështja homerike
9. Tragjediografët
10. Autorët e tjerë të letërsisë së bejtexhinjve: Muhamet Kuçuku e Ibrahim Nezimi

### Shtojca për vitin e dytë

1. Përshkrimi
2. Interpretimi
3. Përfaqësuesit e tjerë të iluminizmit: Teodor Haxhifilipi, Dhanil Haxhiu
4. Viktor Hygo - *Dita e fundit e një të burgosuri*
5. Aleksandër Pushkini - *Eugjeni Onjegin*
6. Mbledhësit e tjerë të folklorit: Zef Jubani, Spiro Dine, Vinçens Prenushi, Bernardin Palaj
7. Zef Serembe - Poezia "Miqësia"
8. Zef Skiroi- *Te dheu i huaj*
9. Anton Santori - *Emira*
10. Sami Frashëri - sipas zgjedhjes
11. Filip Shiroka e Luigj Gurakuqi
12. Gi de Mopasani - *Babai i Simonit*
13. Tolstoj - *Ana Karenina*
14. Mihal Grameno - *Oxhaku*

Lekturë shtëpie

15. Branisllav Nushiq - *Deputeti i popullit*

### Shtojca për vitin e tretë

1. Lidhjet midis leksemave dhe vlerat stilistike të leksemës
2. Zhargonizmat dhe vulgarizmat
3. Polisemia
4. Fjalorët terminologjikë
5. Transkriptimi dhe transliterimi
6. Reportazhi
7. Artur Rembo: *Ofelia*
8. Malarme: *Mjellma*
9. Gustav Floberi: *Zonja Bovari*

10. Asdreni: *Psalme murgu*
11. Autorë të tjerë të shkollës letrare të Shkodrës (informativisht)
12. Nonda Bulka: *Intervistë me malësin*
13. Mithat Frashëri: *Hi dhe shpuzë*
14. Ernest Koliqi: *Shija e bukës së mbrumë*
15. Rrëfimi në vetën e parë dhe të tretë

Lektyrë shtëpie

16. Enver Gjerqeku: *Xixa stralli*

### **Shtojca për vitin e katërt**

1. Fjalitë e ndërmjetme dhe të ndërshtëna
2. Tipat e gjuhëve, gjuhët në botë dhe ngjashmëritë gjuhësore
3. Shpallja, ankesa, polemika
4. Retorika, kuptimi dhe zhvillimi
5. Redaktimi
6. Beketi: *Duke pritur Godonë*
7. Virgjinia Vulf: *Një dhomë për vete*
8. Borhesi: *Pritja*
9. Kasem Trebeshina: *Stina e stinëve*
10. Jusuf Buxhovi: *Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit*
11. Zejnullah Rrahmani: *Sheshi i unazës*
12. Besnik Mustafaj: *Vera pa kthim*
13. Bilal Xhaferri: *Proza*
14. Arshi Pipa: *Libri i burgut* (fragmente)
15. Voreo Ujko: *Poezi*
16. Sabri Hamiti: *Poezi*
17. Visar Zhiti: *Poezi*
18. Ivo Andriq: *Ura mbi Drinë*
19. Danillo Kish: *Enciklopedia e të vdekurve.*

## 5. UDHËZIMET DIDAKTIKE

### Udhëzimet didaktike – mësimi i gjuhës

Mësimi i e mesme profesionale bazohet në tekstet jo letrare që nxënësit, me ndihmën dhe sugjerimin e mësimdhënësit, i kërkojnë ato në gazeta, revista, radio, televizion, internet etj. Tekstet gjuhës në shkollat e mesme profesionale është i lidhur ngushtë me dijet e përfituara nga shkolla fillore. Por në shkollat e mesme profesionale ato zgjerohen dhe thellohen më tej.

Mësimi i gjuhës në shkollat duhet të jenë aktuale dhe interesante. Tekstet duhet të jenë edhe të përshtatshme për moshën dhe teknikën e të shkruarit. Ka rëndësi të madhe dhe duhet të kemi kujdes në dhënien e temave për hartimet shkollore të cilat duhet të jenë tërheqëse dhe të zgjojnë interesimin e nxënësve, sepse hartimet ndikojnë në përsosjen e njohurive nga gjuha. Gjithashtu kërkohet që të kenë më tepër kontroll përmes testeve (pa nota, sepse në atë mënyrë nxënësit do të korrigjojnë gabimet e veta).

Tekstet që shërbejnë si bazë për mësimin e gjuhës duhet të kenë vlera të llojllojshme informative dhe të stilit, ashtu që një tekst mund të shërbejë për disa qëllime operative (ushtrime në të folur, ushtrime drejtshkrimore, gramatikore etj).

Është mirë të nxitet puna në grupe, sepse aty shihet bashkëpunimi dhe ndihma reciproke. Gjithashtu është e udhës që gjatë vitit shkollor ndonjëherë t'u lejohet nxënësve që vetë ta organizojnë orën mësimore.

Duhet të kemi kujdes se katër aktivitetet kryesore (të shkruarit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të folurit) duhet të jenë të pranishme në mënyrë të barabartë dhe mundësisht në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë gjuha mësohet sistematikisht dhe nxënësi mund të kontrollohet në çdo klasë dhe i kushtohet një kujdes intensiv.

### Udhëzime didaktike – mësimi i letërsisë

Hartuesit e programit të letërsisë për shkollat e mesme profesionale kanë hasur në probleme të ndryshme, pasi që programi i deritashëm nuk ka pësuar ndryshime që nga fillimi i viteve të 90-ta. Programi i vjetër ka qenë i ndikuar nga bërthama të përbashkëta për letërsi, pastaj nga ideologjia si dhe mungesa e shumë autorëve shqiptarë që bashkë me veprat e tyre ishin larguar nga programet e mëparshme në bazë të diferencimeve politike. Andaj është bërë përpjekje që këto çështje të mënjanohen, por pa pretendim se kemi bërë ndonjë zbulim “epokal”. Në programin e ri mësimor, letërsia shqipe do të paraqitet me autorët më të mirë të saj. Kjo do të mundësojë që të kemi tekste të mira letrare qoftë nga autorët shqiptarë si dhe nga autorë malazezë e botërorë. Në atë mënyrë mësuesit do të kenë mundësi që të definojnë me precizitet qëllimin, pra të arrijnë arsimim funksional të nxënësve.

Mësimdhënësi do të zbatojë lloje të ndryshme metodash dhe do të ketë liri të plotë në zgjidhjen e tyre. Kjo besojmë se do të rrisë cilësinë e përvetësimeve teorike-letrare dhe historiko-letrare në përvetësimin e letërsisë nga nxënësit e shkollave të mesme profesionale. Mendojmë se ky program, nuk është i pandryshueshëm dhe, gjatë punës në të ardhmen, do të pësojë ndryshime të duhura e të nevojshme, me qëllim që ai të përsoset sa më shumë.



Duhet të kemi kujdes se gjatë punës me tekstet letrare të bëjmë lidhjen edhe me lëndët e tjera, si dhe të nxisim te nxënësit punën në grupe, kërkimin e zgjidhjeve alternative, vlerësimin e rezultateve.

Sot shkollat janë të pajisura me mjete të ndryshme teknike (shpresojmë se në të ardhmen do të furnizohen shumë më mirë), prandaj shumë tekste letrare janë dramatizuar ose janë incizuar filma. Kjo ka bërë që nxënësit të lexojnë më pak, por mësimdhënësi me shkathtësi duhet ta orientojë nxënësin në leximin e teksteve të mirëfillta letrare. Duke lexuar tekste letrare, nxënësit jo vetëm se do të ngrenë nivelin e tyre kulturor, por do të përvetësojnë fjalë, shprehje dhe do të aftësohen më mirë, si në të folur ashtu edhe në të shkruar.

Orët mësimore nuk ndahen në orë klasike të analizave dhe përsëritjeve, por janë ndryshe të organizuara. Prandaj kjo do të ndikojë në përvetësimin sa më të mirë të teksteve letrare.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet bibliotekës, sepse përmes saj rritet interesimi i nxënësve për librin dhe në këtë mënyrë pasuron dijet. Imperativ i kohës është edhe shfrytëzimi i fjalorëve, enciklopedive dhe sidomos i internetit.

Qëllimi i përgjithshëm i mësimin të letërsisë dhe gjuhës është zhvillimi i personalitetit të nxënësit, zhvillimi i aftësive dhe i veprimtarive në jetën shoqërore, përkatësisht jeta aktive në shoqërinë demokratike e cila zhvillohet pa ndërprerje.

Problem i veçantë janë librat, të cilët duhet të lehtësojnë konceptin e të mësuarit aktiv. Është fjala për libra leximi të ndryshëm nga ata të mëparshmit, të përshtatur qëllimit që njohuritë kryesore të arrihen në orën e mësimin.

## 6. KORELACIONI (LIDHJA) MES LËNDËVE

Për mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, lidhja midis lëndëve është shumë e vlefshme dhe e domosdoshme.

Së pari, mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe është parakusht që nxënësit të arrijnë rezultate të duhura edhe në kuadër të lëndëve të tjera.

Mësimi i gjuhës amtare nënkupton lidhjen me mësimin e gjuhëve të huaja. Në këtë mënyrë nxënësit krijojnë bindjen për njohuri gjuhësore si sistem funksional, për zbatimin e përgjithshëm të njohurive, por edhe në specifikat e veçantitë e çdo gjuhe. Në kuadër të kurikulimit do të ishte mirë të vazhdohej në atë mënyrë që mësimi i gjuhës amtare të shkonte në një hap me mësimin e gjuhëve të huaja.

Mësimi i letërsisë nënkupton lidhjen në përbajtje me historinë, artin figurativ e muzikor, psikologjinë, sociologjinë, filozofinë.

Lidhja me mësimin e shkencave natyrore dhe informatikën zhvillon, mundëson përvetësimin e shkathtësive që ofron jeta në epokën pas industriale dhe informatike.

## 7. STANDARDET E NJOHURIVE (KATALOGU I PROVIMEVE)

### Standardet minimale; mësimi i gjuhës

1. Në kuadër të njohurive të përgjithshme për gjuhën, nxënësit duhet të dinë:
  - ç'është gjuha, veçoritë e saj dhe funksioni;
  - të sqarojë zhvillimin e gjuhës;
  - zhvillimi dhe llojet e shkrimit;
  - familjet e gjuhëve;
  - të përcaktojë vendin e gjuhës amtare në familjen e gjuhëve;
  - si normëzohet dhe standardizohet gjuha;
  - drejtshkrimi, fjalorët, gramatikat;
  - dialektet dhe të folmet.
  
2. **Njohuri nga gramatika**
  - strukturën e gjuhës dhe shkencat që merren me të;
  - ndryshime tingëllore dhe përdorimi i drejtë i tyre në të folur e në të shkruar;
  - theksimi i drejtë;
  - llojet e fjalëve dhe veçoritë e tyre ( kategoritë gramatikore e funksionet sintaksore);
  - ndryshimi fjalëve (lakimi, zgjedhimi);
  - terma leksikore;
  - t'i përdorin fjalët si duhet;
  - të njohin tipin dhe karakterin e teksteve në bazë të leksemave;
  - ç'janë frazat, termat, kalket, klisjet;
  - drejt dhe qartë të shprehë mendimin, të bashkojë pjesët e fjalisë;
  - të dallojë vlerat informative e stilistike të fjalisë;
  - të zbërthejë fjali të përbëra në fjali të thjeshta e të zgjeruara;
  - sistemi i rasave: të përdoret drejt në të folur dhe në të shkruar;
  - të përdorë drejt pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, parafjalën, lidhëzën, pjesëzën;
  - foljen: kohët, mënyrat, vetat, zgjedhimet.
  
3. **Njohja e drejtshkrimit**
  - përdorimi i shkronjës së madhe në shkrim;
  - të shkruajë shkurtesat;
  - të ndajë e të bashkojë drejt fjalët në shkrim;
  - të ndajë drejt fjalët në fund të rreshtit;
  - theksimi i drejtë dhe përdorimi i shenjave të pikësimit ku duhet;
  - të përshtatë fjalët nga gjuhët e huaja në gjuhën amtare.

**4. Për kulturën e leximit, të shkrimit, të dëgjimit e të folurit:**

- të zbatojë rregullat gramatikore drejtshkrimore;
- të normëzojë tekstin e caktuar;
- të flasë e të shkruajë qartë, drejt dhe kuptueshëm;

**Dëgjimi i të folurit:**

Nxënësi:

- kupton ç'është lexuar (dëgjuar ose parë);
- di të përsërisë, të ritregojë përmbajtjen;
- mund të përgjigjet në pyetjen lidhur me tekstin;
- di të komentojë (të japë vlerësim kritik) tekstet;
- mund të dallojë qëllimin, stilin, kuptimin, rregullat gjuhësore, qëndrimin e autorit të tekstit;
- mund të ndreqë gabimet e moskuptimet;
- di të tregojë ngjarjen;
- di ta pasurojë atë me emocionet e veta;
- mund të dallojë stilet funksionale, llojet e tyre, e ti përjetojë në mënyrë kritike;
- di të përgatisë fjalimin (paraqitjen me gojë);
- di të shprehet bukur në të folur;
- di të bëjë rezyrenë;
- është i aftë të bashkëbisedojë dhe të polemizojë;
- di të argumentojë qëndrimet;
- është i aftë të përdorë kohën në mënyrë racionale;
- vlerëson bashkëbiseduesin;
- në bazë të dëgjimit, njih biografinë, udhëpërshkrimet, reportazhet, esenë.

**Të lexuarit:**

- di të lexojë qartë, drejt dhe rrjedhshëm;
- di të theksojë, të përdorë heshtjen (pauzën);
- kupton atë që ka lexuar;
- di të lexojë duke i kushtuar kujdes stilit.

**Të shkruarit:**

- di të bëjë hartimin në mënyrë të pavarur;
- di të shkruaj ese;
- di të shkruaj rezyrenë;
- di të shkruajë shënime, kujtesa, regjistrime;

- njeh dhe shkruan me stile të ndryshme funksionale dhe shfrytëzon format e tyre;
- teksti i shkurtër i stilit shkencor;
- llojet publicistike: lajmi, informata, intervista, reportazhi;
- llojet administrative: kërkesa, ankesa, urimi, konkursi, shpallja;
- di të shkruajë udhëpërshkrim, biografi si tekst artistik dhe jo artistik;
- di të bëjë lektorimin e tekstit;
- mund të stilizojë tekstin.

#### **Standardet minimale – mësimi i letërsisë**

- nxënësit janë në gjendje të dëgjojnë, lexojnë dhe interpretojnë veprat letrare nga koha antike e deri në kohën tonë;
- pas leximit të tekstit letrar janë në gjendje të shprehin ndjenjat e veta, përjetimet dhe ç'kanë mësuar aty;
- nxënësit janë në gjendje të analizojnë sipas parimeve që kanë mësuar në teorinë e letërsisë;
- janë të aftë të vlerësojnë arritjet etike, estetike dhe njohëse të tekstit të lexuar;
- mësimin e letërsisë janë në gjendje ta lidhin me përvojën dhe njohuritë e veta nga fushat e tjera të jetës. Nxënësit janë në gjendje të përgatiten e të tregojnë për veprën e lexuar, të komentojnë veprën, të bëjnë krahasime letrare;
- aftësinë e përjetimit të letërsisë e tregojnë edhe me anë të shprehurit të tyre dhe me recitim përmendsh të teksteve të shkurtra letrare;
- janë në gjendje të shkruajnë për pjesën e lexuar, ta parafrzojnë, ritregojnë, analizojnë e vlerësojnë;
- nxënësit janë në gjendje të shkruajnë tekstin ku tregojnë për heroin, për ndonjë problem të caktuar, raportin për leximin në shtëpi etj.;
- njohin epokat dhe drejtimet letrare, mund t'i krahasojnë dhe vlerësojnë arritjet e tyre;
- lidhin teorinë dhe historinë e letërsisë me sistemin e njohurive koherente;
- në mënyrë të pavarur dhe të arsyeshme përdorin njohuritë teorike për letërsinë.

#### **Standardet për:**

##### **Klasën e parë**

- Nxënësi duhet të dijë të lexojë tekstin letraro-artistik (fragmentin nga teksti) nga letërsia bashkëkohore si dhe tekstet letrare nga antika e deri në Rilindjen evropiane;
- të shprehë përjetimet, ndjenjat, mendimet për veprën letrare-artistike;
- në bazë të tekstit të caktuar përcakton gjininë letrare (lirikën, epikën, dramatikën) dhe llojet letrare;
- di të sqarojë veçoritë e gjuhës poetike: figuracionin, emocionin, ritmin;
- në tekstin lirik di të gjejë figurat kryesore stilistike (metaforën, simbolin, krahasimin, personifikimin, anaforën, epiforën, alegorinë, asindetin, polisindetin, ironinë, hiperbolën etj.);
- di të bëjë analizën e vargut sipas ligjeve të vargëzimit në gjuhën tonë;

- di të bëjë dallimin mes veprës epike në vargje dhe veprës epike në prozë;
- di të gjejë elementet strukturore epike: hapësira, koha, ngjarja;
- dallon nocionet: përmbajtje, fabul, subjekt;
- dallon motivin dhe motivimin;
- njeh veçoritë e këngës epike dhe epit, sidomos stilit epik sipas shembujve të poezisë sonë epike;
- dallon tregimin, novelën dhe romanin;
- dallon pozitën e tregimtarit në veprën prozaike;
- dallon tekstin dramatik dhe elementet strukturore të tij;
- di të bëjë krahasime letrare të bazuara në kontraste gjatë epokave letrare ose mbi bazën e motivimit tematik;
- di për vlerat etike të veprës;
- përgatit dhe flet për tekstin letrar-artistik;
- interpreton përmendsh tekste të shkurtra letrare duke treguar aftësinë e përjetimit estetik;
- harton punimin për veprën e lexuar: përshkruan personazhet, tregon veprimin, komenton veprën dhe bën analizën e saj;
- përpiqet të hartojë tekste letrare nën ndikimin e veprave të lexuara.

#### **Klasën e dytë**

- sqaron ndryshimet në kuadër të gjinive letrare gjatë epokave dhe stileve që nga baroku e deri në fund të realizmit;
- krahason dhe dallon barokun dhe klasicizmin, jep karakteristikat e iluminizmit, dallon klasicizmin me romantizmin si dhe romantizmin me realizmin;
- di të bëjë analizën stilistike të poezisë romantike shqipe, vlerat estetike;
- sqaron formën e poemës si lloj i rëndësishëm i romantizmit;
- di të bëjë dallimin e veçorive të realizmit si drejtim letrar dhe realizmit shqiptar në veçanti;
- di të flasë për romanin dhe të bëjë analizën e shtresave të tij;
- di për zhvillimin e romanit, llojeve të tij, romanit në vargje, romanit shoqëror...;
- interpreton ndonjë tekst letrar në mënyrë shprehëse;
- flet para nxënësve dhe mësimeve për ndonjë vepër të zgjedhur letrare;
- shkruan vështrim për veprën, komenton veprën letrare në bazë të përjetimeve dhe vëzhgimeve të veta, di të tërheqë paralele letrare.

#### **Klasën e tretë**

- lexon me kuptim tekstet letrare të letërsisë moderne të zhvilluar nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX;
- di të sqarojë vlerat lirike të poezisë moderne;
- di të sqarojë simbolin si figurë qendrore moderne;
- di të analizojë vlerat stilistike e poetike të letërsisë sonë moderne;
- sqaron hermetizmin në lirikën moderne;
- sqaron asociacionet që sjellin figurat në poezinë moderne evropiane, shqipe...;
- njeh zhvillimin e romanit e sidomos të romanit psikologjik, romanit lirik e llojeve të tjera të romanit;

- është në gjendje të njohë elementet strukturore epike, elementet strukturore dramatike;
- në mënyrë shprehëse interpreton përmendësh një tekst letrar;
- shkruan ese për veprën e lexuar.

**Klasën e katërt**

- lexon me kuptim tekstet letrare nga letërsia bashkëkohore;
- sqaron lirikën hermetike të shekullit XX duke u bazuar në njohuritë e arritura në klasat e mëparshme;
- heton dhe shpreh elementet e komplikua tradicionale dhe moderne në veprat letrare;
- heton lidhjet intertekstuale të poezisë me veprat e tjera letrare si dhe me mitologjinë, historinë, filozofinë etj.;
- njih llojet e romanit modern dhe postmodern;
- kupton antidramën dhe një gjuhën e saj skenike;
- dallon qasjen e brendshme dhe të jashtme të veprës letrare;
- njih principet kryesore të teorive bashkëkohore letrare dhe zbaton modele të analizave të tyre: formalizmit, strukturalizmit, fenomenologjisë, semiotikës etj.;
- ka një pasqyrë të përgjithshme për historinë e letërsisë;
- në mënyrë shprehëse, interpreton përmendsh një tekst letrar;
- shkruan ese të gjatë për një vepër ose më shumë vepra ku mund të tërheqë paralele letrare.

**Në Programin e lëndës futen të gjitha veprat e detyrueshme që punohen gjatë shkollimit katërvjeçar në shkollat profesionale dhe janë të shprehura në kolonën Nociene/përmbajtje**

## 8. MËNYRA E KONTROLLIT TË NJOHURIVE DHE VLERËSIMI

Verifikimi i njohurive dhe vlerësimi mundësojnë përcjelljen e zhvillimit individual të nxënësit dhe nxisin motivimin e tij për punë të vazhdueshme.

Verifikimi i dijeve mund të jetë diagnostik, i rregullt dhe përfundimtar.

Kontrolli diagnostik përdoret në fillim të vitit shkollor për të vërtetuar nivelin e njohurive të fituara dhe për ta drejtuar procesin mësimor drejt rritjeve të reja në mësim. Ai mund të përdoret edhe gjatë vitit shkollor si provë e suksesit të metodave të mësuesit e formave të punës. Duke iu falënderuar këtij kontrolli edhe nxënësit edhe mësime të krijuara krijojnë një pamje për punën e tyre të deriatëhershme.

Rezultatet e punës diagnostike duhet të analizohen në klasë dhe me secilin nxënës veç e veç, nëse ajo është e domosdoshme. Ata nuk do të duhej të vlerësoheshin numerikisht, por në qoftë se mësime të përcaktohet që ato rezultate t'i vlerësojnë me numra, ato nuk do të duhej të shkruheshin në regjistër (ditar) si nota, por të jenë vetëm tregues për punën e mëtejshme e mësime të atëherë mund t'i ketë parasysh në "dosjen" e punës komplete të nxënësit.

Kontrolli i rregullt i njohurive ndjek sukseset dhe përparimin gjatë gjithë vitit. Nxënësi duhet të jetë i njohur me kriteret në bazë të të cilave vlerësohen njohuritë, duhet të ketë udhëzimet e duhura, ndërsa vlerësimi duhet të ketë karakter stimulues, pra duhet të vlerësohen njohuritë e nxënësit dhe jo pa njohuritë e tij.

Kontrolli i vazhdueshëm mund të jetë me shkrim dhe me gojë. Për ndjekjen e përparimit dhe kontrollimit të njohurive, mund të përdoren testet joformale pas realizimit të kapitullit ose fushës së caktuar. Ato duhet të jenë të qarta, të lidhura ngushtë me përmbajtjen e kaluar dhe të bazuara në tipat e të dhënave e metodave që janë praktikuar në orën mësimore.

Çdo nxënës do të duhej të kishte "kartonin" në të cilin do të shiheshin rezultatet e të gjitha kontrolleve me numër e me shkrim. Në këtë mënyrë do të mundësohet ndjekja e gjithanshme e njohurive të fituara, aftësitë ushtruese të nxënësit dhe do të planifikoheshin forma të veçanta pune dhe ndihme, nëse është e nevojshme.

Kontrolli përfundimtar përdoret për të vërtetuar përfundimisht njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në fund të vitit shkollor ose të një periudhe disavjeçare.

Kontrollohet kuptimi i tekstit të dëgjuar dhe të lexuar, si dhe aftësia në të folur e në të shkruar.

Vlerësohen:

- detyrat e shtëpisë dhe hartimet shkollore;
- paraqitja me gojë;
- recitimet;
- njohuritë dhe aftësitë në kuadër të punës me grup.

## 9. RESURSET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

### a) Kushtet materiale

Kushtet materiale nënkuptojnë: klasën me kushte të mira për punë, kabinete, bibliotekë dhe mjete për përgatitjen e mësimit. Do të ishte mirë sikur mësuesi të kishte bashkëpunëtorë të përgatitur mirë gjatë zbatimit të reformës.

Mjetet e nevojshme janë: televizioni, magnetofoni, grafoskopi, kompjuteri.

Në kërkesën organizative janë: shëtitjet, ekskursionet, shikimi i shfaqjeve teatrale.

Programi i reformuar nuk mund të zbatohet pa librat përkatës.

### b) Literatura:

1. Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1989
2. Prof. Gjergj Zheji, Prof. As. dr. Natasha Xhafka "Fjalor enciklopedik letrar", Tiranë, 2001
3. Bahri Beci "Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë", Tiranë, 2004
4. Grup autorësh "Mësuesi, shkolla dhe shoqëria", Prishtinë 1997
5. Grup autorësh "Studio gjithçka, arsyes vendin e parë", Tiranë, 1998
6. Bardhyl Musai "Metodologjia e mësimit", Tiranë, 2003
7. Grup autorësh "Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit", Tiranë, 1998
8. Prof. Gjergj Zheji, Prof. as. dr. Natasha Xhafka "Kommenti letrar" (në ndihmë të mësuesve), Tiranë, 1998
9. Sabri Hamiti "Vetëdija letrare", Rilindja, Prishtinë, 1989
10. Dr. Agim Vinca "Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)", Rilindja, Prishtinë, 1985
11. Bajram Krasniqi "Kode të ligjërimit letrar", Rilindja, Prishtinë, 1988
12. Rexhep Ismajli "Gjuhë dhe etni", Rilindja, Prishtinë, 1991
13. Ibrahim Rugova "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë 1980
14. Anton Berisha "Shumësia kuptimore", Rilindja, Prishtinë, 1990
15. Rexhep Qosja "Histori e letërsisë shqipe"(Romantizmi I, II, III), Rilindja, Prishtinë, 1984, 1986
16. Milivoje Sollari "Teoria e letërsisë", Prishtinë, 1978
17. R. Velek/ O.Voren "Teoria e letërsisë", Prishtinë, 1982
18. Stefan Çapaliku "Letërsia e interpretuar", Tiranë, 1998
19. Isuf Zeneli, Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Prishtinë, 2003

## 10. PROFILI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE E MËSIMDHËNËSVE

(Sipas Rregullores që parasheh këtë veprimtari)



Katalogun e njohurive - Programi i lëndës **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI** për klasën I, II, III dhe IV të shkollës së mesme **profesionale** e ka përpiluar komisioni në përbërje:

**Haxhi Shabani**, kryetar

**Hava Perezizq**, anëtare

**Sume Kokaj**, anëtare

